



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-14300

Dt. 16.02.2026

PRIZREN.

DREJTORIA PËR URBANIZM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR – Komuna e Prizrenit, duke vendosur sipas kërkesës së Shoqata e Biznesmenëve dhe Zejtare “ESNAF” nga Prizreni me seli në rrugën :”Remzi Ademaj” p.n. lidhur me shfrytëzimin e hapësirës publike në Kej-in përballë “Lidhjes Shqiptare” të Prizrenit tek 6 qeshme Topokli në rrugën “Vatrat Shqiptare” në Prizren, për vendosjen e tendës së Iftarit gjatë muajit të Shenjët të Ramazanit në periudhën nga 19.02.2026 deri më 19.03.2026 ,e konform nenit 109,paragrafi 2 të Vendimit Komunal për rregullimin e Qytetit dhe të shërbimeve Komunale të Komunës së Prizrenit nr:01/011-2 datë 18.11.2004, komfor nenit 5 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1 e lidhur me nenin 6, 7 paragrafi 2.1 nenit 8, 9, 10, 11, 13 të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, Nr. 001/011 – 113879, të datës 29 korrik 2022, dhe nenin 26 paragrafi 26.1, pika 26.1.1, të Rregullores 02/2022, për Taksat Komunale, Nr. 001/011-99275, të datës 30 qershor 2022, lëshon këtë:

P Ë L Q I M

I-Me të cilën i lejohet Shoqata e Biznesmenëve dhe Zejtare “ESNAF” nga Prizreni që të bëjë vendosjen e tendës së Iftarit gjatë muajit të Shenjët të Ramazanit në periudhën nga 19.02.2026 deri më 19.03.2026 në hapësirës publike në Kej-in përballë “Lidhjes Shqiptare” të Prizrenit tek 6 qeshme Topokli në rrugën: “Vatrat Shqiptare” në Prizren.

II.Të përmbaheni Rekomandimit të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore të Prizrenit me Nr: 32 /2 të datës **16.02.2026**

III-Nuk lejohet asnjë aktivitet tjetër(muzikë,shërbim me pije te ndryshme-koktej apo të ngjashëm).

IV-Obligohet Shoqata e Biznesmenëve dhe Zejtare “ESNAF” , me seli në Prizren , që pas skadimit të afatit të caktuar kohorë të njëjtin të dislokoj duke liruar hapësirën , respektivisht vendin të kthej në gjendjen e mëparshme

Zana Belloda inxh.dip.ark

